



Botimi Nr. 3. Korrik 2018

Ky është një botim informues për kancerin e gjirit nga Europa Donna Albania dhe shpërndahet falas në të gjithë Shqipërinë.

Të (mos) humbësh luftën me kancerin

**Dhimbjet e gjirit,
pse shkaktohen dhe
çfarë fshihet pas tyre ?**

Prognoza: Do jetojë!

**Impakti dhe sukcesi i
advokimit, rimbursimi
i barit të kancerit të gjirit**



Përmbajtja

“Bashkë do ja dalim”, beteja me kancerin e gjirit	3
Dhimbjet e gjirit, pse shkaktohen dhe çfarë fshihet pas tyre ?	4
Prognoza: Do jetoje !	7
Sëmundjet tumorale në Shqipëri, shifrat alarmante dhe statistikat nëpër qarqe	8
Kanceri dhe seksualiteti, udhëzimet e onkologëve të SHBA	10
Europa Donna Albania përzgjidhet nga ‘Forumi European i Pacientëve’	12
Impakti dhe suksesi i advokimit, rimbursimi i barit të kancerit të gjirit.....	13
Të (mos) humbësh luftën me kancerin	14
Caffe Donna’, takim me anëtarët e EDA.....	14
Formular anëtarësimi	15



“Bashkë do ja dalim”, beteja me kancerin e gjirit

Historia e dy grave që kanë luftuar dhe ja kanë dalë, ende luftojnë...

Të veshura me shije dhe mjaft optimiste për jetën, Oltiana dhe Brunilda janë dy gra, të cilat jeta i përballi me sëmundjen e kancerit të gjirit.

Oltia ia ka dalë dhe Bruna ende lufton...

Nuk janë nga ato skenaret e famshme të regjisorëve të Hollywood-it por një realitet i hidhur por i luftuar me krenari e dinjitet, me dëshirën e madhe për jetën.

Oltiana Petri është mjeke mikrobiologe, me një optimizëm dhe një dëshirë të madhe për ta jetuar jetën. Olta është një nga ato gratë që nuk dorëzohet lehtë, luftoi shumë dhe ia doli të jetë fitimtare mbi sëmundjen e shekullit.

“Pesë vite më parë, kur nuk kisha mbushur ende të 36-at, në prag Krishtlindjesh kisha shkuar të vizitoja dhe të festoja me të afërmit. Aty kuptova se diçka nuk shkonte me trupin tim,”- kështu nis historia e doktoreshës mikrobiologe e cila edhe pse e ka fituar betejën, nuk lë pas dore kontrollet e vazhdueshme mjekësore. Ashtu siç mban nën kontroll punën që zhvillon çdo ditë në laborator si mjeke mikrobiologe dhe aktivizohet me Europa Donna Albania, për t’i ardhur në ndihmë grave me kancer gjiri dhe për të ndërgjegjësuar çdo vajzë e grua në Shqipëri.

Olta, nënë e dy djemve, bashkëshortë, motër dhe bijë, e megjithatë ajo nuk kërkonte keqardhje nga askush. As atëherë kur u dërgonte mikesve të saj në Whatsapp fotografi dhe u thoshte: “Mos e lini veten tuaj pas dore. E shikoni si jam katandisur?

Pa flokë, pa vetulla...”.

Nga ana tjetër, Brunilda Alimerkaj, lufton me këtë sëmundje prej 10 vitesh. Nëse e shikon Brunën nuk të shkon mendja kurrë se me çfarë i është dashur të përballet. Është gjithnjë e kuruar deri në detaje, me fustanet tip sportive por që kanë pak klas brenda dhe me atletet e saj të preferuara “All stars”, Bruna është gjithnjë në lëvizje dhe nuk humb asnjë sekondë nga jeta.

Bruna ka shumë miq dhe shumë dashuri përreth, dy gocat dhe prindërit. Asaj i duhet të udhëtojë shpesh drejt Italisë për t’u trajtuar, por asnjëherë nuk lë pas dorë vëmendjen ndaj grave paciente në Shqipëri, e gatshme për t’i ndihmuar kurdo.

Në vitin 2007 Bruna nisi kalvarin e saj të vuajtjeve në spitale, në moshën 30-vjeçe, nënë e dy vajzave mësoi se është me kancer. Sikur mos të mjaftonte kjo, bashkëshorti pasi mori vesh për sëmundjen, e braktisi Brunën dhe vajzat. Por kjo nuk e pengoi Brunën të luftonte për jetën e saj, për vajzat dhe për prindërit dhe ia doli mbanë. Pas trajtimeve iu kthye jetës normale, punës dhe familjes.

Por në vitin 2015 do të diagnostikohej sërish me kancer, këtë herë sëmundja kishte prekur mushkërit. Bruna është ende duke u trajtuar, që të mbajë nën kontroll sëmundjen.

Bruna dhe Olta, dy gra me histori të ndryshme kanë një emërues të përbashkët: luftojnë për të jetuar. Ato kanë një mesazh dhe apel për vajzat dhe gratë, që të kenë kujdes për shëndetin e tyre dhe të bëjnë kontrolle të vazhdueshme.





Dhimbjet e gjirit, pse shkaktohen dhe çfarë fshihet pas tyre ?

Dhimbjet e gjirit, pse shkaktohen dhe çfarë fshihet pas tyre ?

Dhimbjet e gjirit janë një dukuri klinike shumë e shpeshtë dhe mund të takohen në gratë e të gjitha moshave. Në raste shumë më të rralla, dhimbjet e gjirit, mund të takohen edhe tek djemtë, zakonisht gjatë moshës së pubertetit, si rrjedhojë e ndryshimeve zhvillimore të gjinjve nën efektin e hormoneve seksuale. Ky shkrim përmbledh një informacion se çfarë përfaqësojnë dhimbjet e gjirit, nga se shkaktohen, kur shfaqen, sa të shpeshta janë dhe çfarë rreziku real paraqesin për gruan.

Cilat janë shkaqet e dhimbjeve të gjirit?

Dhimbjet e gjirit mund të lindin nga shkaqet e shumta dhe të ndryshme. Në varësi të tyre, dhimbjet e gjirit grupohen në dy kategori kryesore:

- Dhimbjet e shkaktuara si rrjedhojë e ndryshimeve normale, fiziologjike, që ndodhin pa pushim në gjirin e gruas, nën ndikimin e faktorëve hormonale.
- Dhimbjet e shkaktuara si rrjedhojë e gjendjeve patologjike dhe sëmundjeve të ndryshme të gjirit. Dallimi nëse një dhimbje e shfaqur në gjinje bën pjesë në njërin apo në tjetrin grupim është tepër i rëndësishëm si për mënyrën e trajtimit të saj ashtu dhe për fatin e mëtejshëm të gruas.

a. Çfarë janë dhe si shpjegohen dhimbjet "fiziologjike" të gjirit?

Gjiri është një organ në ndryshim të vazhdueshëm. Gjatë gjithë jetës, që nga vitet fëmijërisë e deri në moshën e thyer, organizmi i gruas dhe indi i gjirit, në veçanti, kalon nëpër disa etapa të njëpasnjëshme zhvillimi siç janë :

- Puberteti kur vajzës i fillojnë menstruacionet

e para

- *Periudha e pjekurisë seksuale* kur organizmi i saj bëhet i aftë të kryejë normalisht të gjitha funksionet fiziologjike madhore që janë pjesë e pandarë e jetës së një gruaje të rritur siç janë, jeta aktive seksuale, shtatzënia dhe laktacioni (ushqyerja e foshnjës me gjii)
- Menopauza kur gruas gradualisht i ndërpriten menstruacionet dhe ajo humbet aftësinë riprodhuese, domethënë, aftësinë për të mbetur shtatzënë dhe për të lindur fëmijë.

Edhe pse këto cikle madhore ndryshimi, janë procese fiziologjike që ndodhin normalisht tek çdo grua nën efektin e hormoneve seksuale, zakonisht, ato shoqërohen me një varg ndjesish, shqetësimesh, dhe shfaqjesh klinike të ndryshme, herë më të qeta dhe herë më të shprehura. Në mozaikun heterogjen dhe të larmishëm të shenjave dhe simptomave që shoqërojnë proceset fiziologjike, normale të zhvillimit të gjirit, një nga shfaqjet klinike më kryesore dhe më shqetësuese janë pa dyshim, dhimbjet e gjirit. Të gjitha këto shfaqje klinike lidhen thjesht me ndryshimet hormonale normale që ndodhin në organizmin e gruas dhe nuk paraqesin asnjë rrezik serioz as për jetën dhe as për shëndetin e saj. Rëndësia kryesore e tyre qëndron në faktin se shpesh ato mund të imitojnë simptomatologjinë klinike të sëmundjeve apo patologjive reale të gjirit dhe, për këtë arsye, për diagnostikimin e saktë të tyre shpesh është i nevojshëm këshillimi dhe vizita klinike tek një mjek specialist i sëmundjeve të gjirit .

b. Dhimbjet e shkaktuara nga sëmundjet apo gjendjet patologjike të gjirit

Përveç ndryshimeve të shkaktuara nën efektin e hormoneve femërore, gjiri është një organ i preferuar dhe terren mjaft i favorshëm për zhvillimin e një numri të konsiderueshëm gjendjesh patologjike, tumorale ose jo tumorale. Këto patologji shoqërohen si rregull, me shqetësime, dhe shenja klinike të ndryshme, ku përfshihet dhe dhimbja, të cilat shpesh, janë të njëjta apo tepër të ngjashme me ato që takohen edhe në gjendjet fiziologjike që përshkruam më sipër. Dallimi i saktë, në se shfaqja e dhimbjes apo dhe simptomave të tjera është thjesht një shprehje kalimtare e proceseve fiziologjike që po ndodhin në atë kohë në indin e gjirit apo ka si shkak një patologji më serioze, përbën një nga sfidat më të rëndësishme qoftë për mjekun e përgjithshëm, qoftë për mjekun e specializuar në patologjinë e gjirit.

Në shumicën e rasteve, ndjenja e dhimbjes nuk është tregues i një procesi patologjik të gjirit dhe takohet zakonisht gjatë ndryshimeve fiziologjike dhe hormonale periodike që ndodhen në gj. Megjithatë, pothuaj gjithmonë, ajo krijon tek gruaja e painformuar një ndjenjë të thellë shqetësimi, frike dhe depresioni, çka bën të domosdoshme përcaktimin e saktë dhe sa më të shpejtë të shkakut të saj të vërtetë.

Sa të shpeshta janë dhimbjet gjirit. Kur dhe ku takohen më tepër

Afërsisht, rreth 70% e grave, pra, më shumë se dy në çdo tre gra, përjetojnë episode të ndryshme të dhimbjeve të gjirit në periudha të ndryshme të jetës së tyre. Në përgjithësi, dhimbjet e gjirit janë më shpeshta në gratë që ndodhen akoma në fazën menstruale të jetës së tyre ose afër fillimit të menopauzës. Në gratë që kanë hyrë në moshën e menopauzës dhimbjet e gjirit takohen më rrallë. Dhimbjet mund të jenë të lokalizuara vetëm në njërin gjë ose mund të takohen njëkohësisht në të dy gjinjët e gruas.

Në shumicën e rasteve, dhimbjet ndihen në pjesën e sipërme, të jashtme të gjirit dhe jo rrallë mund të përhapen në drejtim të gropës së sqetullës. Forma e shfaqjes dhe intensiteti i tyre janë të ndryshme dhe varen në radhë të parë nga shkak apo faktori që i ka shkaktuar. Në një numër rastesh, dhimbjet mund të jenë më të lehta dhe shfaqen në formën e një ndjenje rëndimi ose shtrëngimi të thjeshtë në zonën e gjirit. Në raste të tjera ato mund të jenë më të mprehta, në formë therje, djegie, thumbimi ose pickimi.

Si klasifikohen dhimbjet e gjirit në varësi të kohës kur shfaqen në raport me ciklin menstrual të gruas dhe përse kjo gjë është e rëndësishme për tu orientuar mbi natyrën e dhimbjes dhe shkaqet e mundshme të saj?

Në shumicën dërrmuese të rasteve, shkaqet dhe mekanizmat se si dhimbjet e gjirit lindin, lidhen ngushtë me 3 faktorë klinikë të rëndësishëm: a) kohën apo ditët kur ato shfaqen përgjatë ciklit menstrual të gruas, b) kohëzgjatjen e tyre dhe c) faktin nëse shfaqja e dhimbjeve është e rregullt, periodike apo e rastësishme dhe e paparashikuar. Të dhënat apo treguesit e mësipërm mund të na ndihmojnë shumë si një orientim fillestar për të kuptuar natyrën dhe shkaqet e dhimbjes. Bazuar në këtë princip, të gjitha dhimbjet e gjirit ndahen apo klasifikohen në dy kategori kryesore: *dhimbjet ciklike* dhe *dhimbje jo-ciklike*.

Dhimbjet ciklike gjirit quhen të gjitha dhimbjet e gjirit që shfaqen rregullisht gjatë ciklit menstrual. Është e kuptueshme që dhimbjet ciklike takohen vetëm në gratë menstruante (përpara menopauzës) dhe ndajnë mes tyre disa karakteristika të përbashkëta. Si rregull dhimbjet shfaqen rregullisht në mënyrë periodike ose ciklike ashtu si dhe cikli menstrual. Në shumicën e rasteve, dhimbjet fillojnë disa ditë përpara fillimit të menstruacioneve të radhës, por, në disa raste mund të fillojnë edhe më parë. Me fillimin e menstruacioneve dhimbjet ciklike zakonisht qetësohen ose zhduken krejtësisht, për tu shfaqur përsëri në javën, apo ditët përpara se të fillojë cikli menstrual i ardhshëm. Dhimbjet ciklike takohen si rregull në të dy gjinjët në ndryshim nga dhimbjet jo ciklike që takohen zakonisht vetëm në njërin pre tyre. Intensiteti i dhimbjeve mund të luhatet nga dhimbje të lehta deri të rënda dhe në shumicën e rasteve janë më të shprehura në pjesën e jashtme, të sipërme të gjirit. Jo rrallë ato mund të përhapen në sqetull, poshtë krahut dhe në zonën (rajonin) e shpatullës. Shfaqja e dhimbjeve ciklike shoqërohet shpesh më zmadhimin e gjinjve, rritjen e ndjeshmërisë së tyre si dhe theksim të nodularitetit normal të gjirit. Si shpjegohen dhimbjet ciklike të gjirit dhe cilat janë shkaqet që provokojnë shfaqjen e tyre?

Së pari duhet theksuar se dhimbjet ciklike të gjirit nuk lidhen apo nuk krijohen nga shkaqe patologjike. Ashtu si dhe shumë shqetësime apo shfaqje të tjera klinike tek gratë, ato janë rrjedhojë e ndryshimeve që ndodhin në nivelet e hormoneve femërore përgjatë ciklit menstrual të gruas. Struktura dhe fiziologjia normale e gjirit ndodhet nën ndikimin e drejtpërdrejtë dhe

të vazhdueshëm të luhatjeve të tilla. Baticat dhe zbaticat ciklike të niveleve hormonale në gjakun e gruas shoqërohen zakonisht me një varg ndryshimesh dhe ndjesish klinike ku përfshihet dhe dhimbja. Këto ndryshime dhe ndjesi klinike shfaqen dhe zhduken rregullisht, në mënyrë ciklike dhe të përsëritur sepse janë pasqyrim i drejtpërdrejtë dhe respektojnë rigorozisht ciklet ndryshimeve periodike të niveleve hormonale në gjakun e gruas. Pas fillimit të menopauzës, me ndërprerjen e aktivitetit hormonal të ovarëve, dhimbjet ciklike të gjirit, normalisht ndërpriten me përjashtim të rasteve kur gratë, marrin terapi hormonale zëvendësuese për të mjekuar efektet anësore të menopauzës.

Dhimbjet ciklike të gjirit nuk lindin nga shkaqe patologjike. Ato janë shfaqje kalimtare, të përkohëshme, që shkaktohen nga ndryshimet e niveleve hormonale femërore përgjatë ciklit menstrual dhe nuk kanë asnjë pasojë serioze për shëndetin e gruas.

Dhimbjet jo-ciklike gjirit. Në këtë grup përfshihen të gjitha llojet e dhimbjeve që nuk kanë lidhje me ciklin menstrual. Dhimbjet jo-ciklike takohen më rrallë se dhimbjet ciklike dhe mund të takohen si para ashtu dhe pas menopauzës, por, zakonisht, shfaqen më shpesh pas moshës 40 vjeçare. Dhimbjet jo-ciklike mund të jenë të vazhdueshme ose dhimbje që vinë dhe shkojnë, dhe, në përgjithësi, nuk ndjekin ndonjë rregull të qartë të kohës kur shfaqen dhe të mënyrës si qetësohen. Dhimbjet mund të shfaqen në të dy gjinjët, por më shpesh janë të njëanshme dhe përfshijnë vetëm një zonë të kufizuar të gjirit. Dhimbjet jo-ciklike zakonisht stabilizohen vetë në rreth 50% të rasteve. Shkaqet e dhimbjeve jo-ciklike mund të jenë nga më të ndryshmet dhe në një shumicë rastesh përcaktimi i saktë i prejardhjes së tyre mund të jetë mjaft i vështirë. Ndër shkaqet më të

shpeshta mund të jenë infeksionet e gjirit (mastitet), ndryshimet indore si rrjedhojë e obezitetit (shtimit në peshë) ose shtatzënisë, përdorimi i mbajtëseve të papërshtatshme të gjinjve, përdorimi i medikamenteve hormonale si për shembull terapia hormonale zëvendësuese gjatë menopauzës ose pilulat kontraceptive, patologjitë tumorale beninje ose malinje të gjirit, traumat e ndryshme etj. Në disa raste, dhimbjet jo ciklike edhe pse ndjehen në zonën e gjirit, në të vërtetë, e kanë burimin e tyre nga indet jashtë gjirit.

Këto dhimbje quhen dhe dhimbje ektramammare (jashtë gjirit) dhe shkaktohen në shumicën e rasteve nga inflamacioni i muskujve mbi të cilët mbështeten gjinjët ose inflamacioni i strukturave kockore dhe kërcore të kafazit torakal (brinjët dhe pllaka sternale).

A është kanceri një shkak i shpeshtë i dhimbjeve të gjirit?

Megjithëse frika më e madhe dhe shkak i parë i mundshëm që i vjen gruas në mendje sa herë që ka dhimbje në gji, është kanceri, për fat të mirë, e vërteta është shumë më e ndryshme. Dhimbja nuk është një shfaqje klinike karakteristike e kancerit të gjirit . Vetëm 1 në çdo 20 raste të kancerit të gjirit, pra rreth 5% e tyre, mund të shoqërohen me dhimbje.

Dhimbja është një shfaqje klinike as e shpeshtë dhe as karakteristike e kancerit të gjirit . Vetëm 1 në çdo 20 raste të kancerit të gjirit, pra rreth 5% e tyre, mund të shoqërohen me dhimbje.

Megjithatë, pavarësisht faktit se kanceri i gjirit, në shumicën dërrmuese të rasteve, nuk shoqërohet me dhimbje, është e këshillueshme që sa herë që një grua ndjen dhimbje shqetësuese të gjirit, të cilat nuk lidhen me ciklin menstrual, domethënë janë dhimbje jo-ciklike, duhet të këshillohet sa më parë me mjekun specialist.



Prognoza: Do jetojë!



Nga Dr. Joana Millo
Mjeke Onkologe

Kanceri është pjesë e jetës. Tashmë pothuaj çdo njeri e ka të qartë faktin që secili prej nesh mund të përballet me këtë sëmundje personalisht apo në rrethin e ngushtë familjar. Nuk dëshiroj t'ju trishtoj, por t'ju kujtoj që pranimi i një problemi është hapi i parë për ta zgjidhur atë.

Hapi i dytë është patjetër informimi. Ndaj me anë të kësaj letre dëshiroj t'ju informoj për hapat e mëdha të bërë në trajtimin e kancerit të gjirit. Më shpesh flasim për sukseset e zbulimit të hershëm dhe diagnostikimit.

Por mendoj që gjithashtu me shumë interes për ju është të fokusohemi edhe në mundësitë e trajtimit që ofrohen për kancerin e gjirit.

Çfarë është e rëndësishme të dihet paraprakisht për të zgjedhur trajtimin optimal?

Mjekut do t'i duhet të vlerësojë disa aspekte të lidhura si me pacientin ashtu edhe me sëmundjen që të mund të vendosë për trajtimin me të përshtatshëm.

Cilat janë disa nga informacionet me relevante të lidhura me pacientin?

Këto janë: Moshë, historia personale mjekësore, historia familjare për neoplazi sidomos për kancerin e gjirit dhe të vezoreve, mirëqenia fizike e pacientit, prezenca ose jo e sëmundjeve të tjera shoqëruese, rezultatet e analizave të gjakut, mirëqenia e organeve të tjera si p.sh. mëlçia dhe veshkat etj.

Cilat janë disa nga informacionet me relevante të lidhura me sëmundjen?

Këto do të ishin: Stadifikimi i sëmundjes në momentin e diagnozës me anë të cilit vlerësohen madhësia e tumorit, prekja e gjëndrave në afërsi dhe largësi si dhe prekja apo jo nga tumori e organeve të tjera në distancë. Rezultatet e Biopsisë që na japin informacion për tipin e qelizës në masën tumorale por edhe në gjëndrat e ekzaminuara, për shkallën e ndryshimit të qelizës tumorale nga qelizat motra të paprekura nga tumori. Statusi HER2 dhe ai i receptorëve hormonale estrogjene ER dhe progesteron PR, që tregojnë se cilat prej këtyre receptorëve shpreh qeliza tumorale në sipërfaqen e saj. Kur këto proteina të sipërfaqes qelizore janë prezente, themi që tumori është HER2, ER dhe PR pozitiv.

Cilat janë opsionet e trajtimit?

Plani i trajtimit të kancerit të gjirit vendoset jo vetëm nga një mjek por nga një grup mjekësh që përbëjnë atë që quhet Ekipi Multidisiplinar dhe ku bëjnë pjesë kirurgu, radioterapeuti, onkologu mjekësor, imazheristi, anatomopatologu etj. Staf i vendos se me cilin opsion të trajtimit do të fillohet, me kirurgji, apo terapi sistemike, apo radioterapi dhe si do të vazhdohet më tej duke përcaktuar saktë atë që quhet "Plani i trajtimit".

Supozojmë që stafi multidisiplinar vendosi në bazë të kriterëve të mësipërme që do të fillohet trajtimi me terapi sistemike, pra me barna që pacienti i merr me serume, nga goja apo nën lëkurë.

Cfarë është terapia sistemike?

Qëllimi i terapisë sistemike është që të arrijë në qelizat tumorale të cilat mund të jenë shkëputur nga tumori primar dhe të kenë migruar në gjak, gjëndra apo organe të tjera. Këtu përfshihen:

- Terapia hormonale
- Kimioterapia
- Terapia e targetuar kundër HER2.

Më sipër përmendëm llojet e receptorëve, prezenca e tyre merr pikërisht këtu kuptim. Nëse tumori shfaq në sipërfaqen e tij receptorët hormonale (ER+ dhe/ose PR+), atëherë ai mund të luftohet me anë të barnave hormonale që i kapin dhe i bllokojnë këta receptorë duke frenuar kështu rritjen e pakontrolluar të qelizës. Këto barna mund të jepen pas ose me kimioterapinë ose edhe vetëm në rastet kur mjekët vendosin që pacientja nuk e ka të nevojshme aplikimin e saj.

Disa nga preparatet hormonale janë: Tamoxifen, frenuesit e aromatizes si anastrozole, exemestane ose letrozole.

Sëmundjet tumorale në Shqipëri, shifrat alarmante dhe statistikat nëpër qarqe

Numri i pacienteve me kancer gjiri në vendin tonë po rritet gjithnjë e më shumë dhe në vitin 2015 ka arritur në 5158 të diagnostikuara, nga 3286 gra të prekura në 2014-ën. Mungesa e medikamenteve vazhdon të mbetet një çështje e mprehtë, pavarësisht ndryshimeve të bëra ndër vite. Një tjetër problem është dhe mungesa e 'Regjistrit Kombëtar të Kancerit të Gjirit'. Shqipëria nuk e ka një të tillë dhe ende flasim me statistika dhe shifra të mbledhura nga disa institucione dhe shërbime të ndryshme dhe Europa Donna Albania.

'Monitor' shkruan se: Shëndeti i popullatës shqiptare po kalon një tranzicion të vështirë për shkak të përhapjes me shpejtësi të sëmundjeve që vrasin shpejt, sidomos ato kardiake dhe neoplazmave (tumoralet). Nga viti 2012-2017 kanë humbur jetën nga sëmundjet tumorale më shumë se 3500 persona çdo vit. Sëmundjet malinje ishin shkaktari i dytë i vdekjeve në Shqipëri gjatë vitit 2017, me një rritje 2.1 për qind në raport me vitin e kaluar.

Por teksa popullsia po tkurret dhe po plaket prej rënies së numrit të lindjeve dhe emigracionit, numri i personave që humbasin jetën nga kjo sëmundje janë në rritje, sidomos në moshat e reja sipas të dhënave zyrtare të INSTAT. Në vitin 2017, numri i personave që humbën jetën nga sëmundjet tumorale ishin 74 më shumë se në vitin 2016.

Sëmundja zgjerohet te moshat të reja

Neoplazmat më parë ishin sëmundje karakteristike për moshat mi 60 vjeç, sidomos ndër duhanpirësit, por gjithnjë e më shumë sëmundja po prek moshat më të reja. INSTAT raportoi se në vitin 2017 humbën jetën nga tumori 10 të rinj të moshës 10-14 vjeç me një rritje 66 për qind në raport me vitin 2016, ku kishin humbur jetën 6 të rinj të moshës së adoleshencës.

Gjithashtu të dhënat tregojnë se ka një rritje të vdekjeve nga tumoret për grupmoshën 40-60 vjeç. Në vitin 2017 u ndanë nga jeta 68 persona të moshës 40-44 vjeç, 10 më shumë se në vitin 2016. Vdekjet u shtuan në grupmoshën 55-59 vjeç, ku humbën jetën 363 persona, 33 më shumë se një vit më parë (shiko tabelën).

Mjekët në klinikën onkologjike në QSUT, pohojnë se vitet e fundit ka shtim të rasteve tumorale sidomos në moshat e reja. Femrat gjithnjë e më shumë po preken nga kanceri i gjirit dhe i uterusit, ndërsa meshkujt nga prostata.

Burimet në Onkologjik pohojnë se rastet me kancer

janë dhjetëfishuar vitet e fundit dhe statistikat nuk janë të sakta. Shumë persona operohen dhe diagnostikohen jashtë, ndërsa ka shumë raste nga Kosova që trajtohen në Shqipëri. Por, përpos numrit në rritje, mjekët janë të shqetësuar se po preket grupmosha e re 20-40 vjeç.

Sipas INSTAT, në 2017-n, vdekjet më të mëdha nga tumoret ishin te meshkujt, me 61% të totalit.

Të dhënat e INSTAT, të përpunuara nga Monitor për 1000 banorë tregojnë se në vitin 2017 është rritur prevalenca e vdekjeve nga tumori për grupmoshat 10-29 vjeç; 40-59 vjeç; ndërkohë që ka pasur ulje për grupmoshat 30-39 vjeç dhe mbi 60 vjeç.

Qarqet më të prekura, Gjirokastra dhe Korça


Numrin më të madh të jetëve të humbura nga sëmundjet tumorale e ka Tirana, për shkak edhe të numrit më të madh të banorëve, por prevalencën më të lartë të jetëve të humbura e ka Qarku i Gjirokastrës, me 2.21 jetë të humbura për 1 mijë banorë. Gjirokastra ka më shumë jetë të humbura për shkak të plakjes së popullsisë me ritme më të larta se në qarqet e tjera. Pas Gjirokastrës vjen Korça me 1.66 të vdekur për 1000 banorë, më pas Shkodra me 1.64 për 1 mijë banorë, Vlora me 1,50 të vdekur.

Numrin për të ulët të jetëve të humbura për 1 mijë banorë e ka Tirana me 0.99 të vdekur për 1000 banorë më 2017, më pas Lezha me 1.05 të vdekur për 1000 banorë, Durrësi me 1.11 jetë të humbura për 1000 banorë dhe Kukësi me 1.17 jetë të humbura për 1000 banorë.


Të dhënat nga administrata e Qendrës Spitalore "Nënë Tereza" QSUT, tregojnë se në repartin e onkologjisë u trajtuan 7 mijë raste të reja në vitin 2017 në raport me rreth 5 mijë raste të reja që ishin në vitin 2014.

Shkaktarët e sëmundjes dhe rekomandimet Ekspertët në Spitalin Onkologjik pohojnë se, ndotja e mjedisit dhe dieta ushqimore janë faktorë përgjegjës për kancerin në rritje. Ata pohojnë se rastet më të shumta janë në zonat e ndotura të vendit sidomos në qytetet industriale, si Elbasani, Fieri dhe zonat kufitare të vendit, sidomos ato me Kosovën, ku ka pasur ndotje në kohën e luftës.

Në vendin tonë, kanceri mund të mbahet në nivele të ulëta nëse rritet kontrolli mbi sigurinë ushqimore, të frenohet duhanpirja dhe të ulet ndotja në mjedis, rekomandojnë mjekët. Nëse këta faktorë rreziku nuk frenohen, mjekët pohojnë se vitet e mëvonshme do të jenë një katastrofë në përhapjen e sëmundjes.



Burimi: INSTAT, përpunime të Monitor



Burimi: INSTAT, përpunime të Monitor

Vdekjet nga tumoret sipas grupmohave							
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Ndryshimi në numër 2017/2016
Gjithsej	3738	3585	3788	3682	3471	3645	74
Nën 1	1	2	1	0	0	0	0
1-4	3	4	2	2	4	2	-2
5-9	3	3	7	1	3	4	1
10-14	3	4	4	3	6	10	4
15-19	9	9	9	7	8	10	2
20-24	18	22	16	12	8	9	1
25-29	26	18	17	14	13	16	3
30-34	34	34	27	21	18	16	-2
35-39	63	41	49	48	39	37	-2
40-44	94	82	82	87	58	68	10
45-49	158	140	159	136	118	124	6
50-54	227	247	256	263	231	230	-1
55-59	394	367	388	317	330	363	33
60-64	384	441	444	454	466	443	-23
65-69	498	451	485	536	510	516	6
70-74	664	607	609	602	543	506	-37
75-79	600	574	617	656	619	610	-9
80-84	340	347	390	410	386	409	23
Mbi 84	219	192	226	204	211	272	61

Burimi: INSTAT

	Vdekjet nga tumoret sipas gjinisë, 2017	
	meshkuj	femra
Berat	121	63
Dibër	81	62
Durrës	195	121
Elbasan	238	140
Fier	244	175
Gjirokastr	93	53
Korçë	242	113
Kukës	56	37
Lezhë	91	44
Shkodër	200	142
Tiranë	500	348
Vlorë	187	96
Të panjohur	2	1
Totali	2250	1395
Burimi: INSTAT		

Kanceri dhe seksualiteti, udhëzimet e onkologëve të SHBA

Për të ndihmuar pacientët dhe mjekët të përballen me pasojat që kanë terapitë e kancerit në sferën seksuale, Asco ka publikuar rekomandimet e tij: Në plan të parë është dialogu i hapur dhe psikoterapia, por edhe trajtimet farmakologjike kundër dhimbjes.

Mara Magistroni e Tiziana Moriconi

Kanceri e ndryshon jetën në çdo këndvështrim: ndryshon mënyrën e përjasjes me njerëzit dhe gjërat, ndryshon zakonet e tyre dhe shkakton ndryshime fizike. Të përzierat, të vjellat, dhimbja, lodhja, gjithashtu dhe depresioni ndikojnë shumë në dëshirën seksuale, duke i bërë ndonjëherë të pamundura marrëdhëniet seksuale. Megjithatë, shumica e pacienteve e kanë të vështirë të flasim me mjekun e tyre lidhur me problemet që kanë të bëjnë me seksin dhe po aq shpesh vetë mjekët e lënë pas dore atë që është një aspekt themelor në trajtim. Në mënyrë që mjekët të vendosen në kushtet për të ndihmuar pacientët me kancer që kanë probleme seksuale, të cilat tumori dhe terapitë sjellin në mënyrë të pashmangshme, Shoqata Amerikane e Onkologjisë Klinike (Asco) ka hartuar udhëzimet e saj.

Rekomandimet e botuara në “Journal of Clinical Oncology” janë hartuar nga grupe ekspertësh duke filluar nga ato ekzistuese të “Cancer Care Ontario” (ÇCO) 2016, bazuar në një analizë të gjerë të literaturës së industrisë dhe në evidencën klinike më solide. Ne i raportojmë ato më poshtë:

1. Bisedoni rreth problemeve të mundshme seksuale para terapisë

Ekspertët e Asco këshillojnë onkologët që të fillojnë të flasim për implikime e jetës seksuale tek pacienti që nga momenti i diagnozës, pra pavarësisht nga ekzistenca e një problemi, për të vazhduar më pas konfrontimin gjatë trajtimit dhe gjatë folloë-up-it. Diskutimi duhet të marrë parasysh nivelin e shkollimit, kulturës dhe besimeve fetare si edhe orientimit seksual. Partneri i pacientit mund të përfshihet në diskutim vetëm nëse ai është i interesuar ta dëshirojë atë. Dokumenti i ri prek aspektet e ndryshme të jetës seksuale të një pacienti me kancer, duke marrë parasysh natyrisht dallimin midis problemeve femërore dhe mashkullore. Përsa i përket grave, në veçanti, ka shumë aspekte për t'u marrë parasysh në lidhje me llojin e çrregullimit, llojin e kancerit dhe terapive.

2. Të luftosh kundër rënies së dëshirës

Për çrregullimet e dëshirës, eksitimit dhe arritjes së orgazmës, ekspertët e Asco, në plan të parë ju rekomandojnë kolegëve t'u ofrojnë pacientëve një konsultim psiko-social dhe psiko-seksual. Stimulimi i rregullt (për shembull nëpërmjet autoerotizmit) gjithashtu rekomandohet dhe mund të jetë i dobishëm. Terapitë farmakologjike (për shembull me flibanserin, të ashtuquajturat “viagra rozë”) duhet të vlerësohen me kujdes, sepse nuk ka shumë të dhëna për raportin e rrezikut apo përfitimeve të pacientët që kanë pasur një histori kanceri apo kanë ndjekur një terapi për të bllokuar hormonet si pasojë e tumorit.

3. Përpjekja për të për të pranuar imazhin e trupit tuaj

Terapia psikologjike, është rruga e duhur që duhet ndjekur për të ndryshuar trupin, i cili ka një ndikim në aftësinë për të krijuar marrëdhënie emocionale dhe për të hyrë në intimitet me partnerin, edhe kur një partner është i pranishëm dhe pacienti e dëshiron atë. Tema duhet të diskutohet edhe para fillimit të terapive, posaçërisht për të nisur rrugën e pranimit të vetvetes. Gratë që vuajnë nga depresionit ose që kanë vështirësi të pranojnë imazhin e trupit të tyre para kancerit, janë veçanërisht të rrezikuara.

4. Trajtimi i mosfunksionit seksual

Tumori dhe terapitë për trajtimin e tij gjithashtu mund të shkaktojnë probleme fizike, të cilat mund të rezultojnë në pamundësinë për të ndjerë kënaqësi gjatë marrëdhënieve seksuale, ose shpesh mund të shkaktojnë dhe dhimbje. Mjekët duhet të kontrollojnë pacientët për të përcaktuar nëse ka probleme të tilla dhe të ofrojnë zgjidhje të mundshme, mundësisht me ndihmën e një gjinekologu.

5. Trajtimi i çrregullimeve ‘vasomotore’

Terapitë sistematike hormonale janë më efektive për gratë me probleme vasomotore. Ndërsa për ato që janë me kancer gjiri nuk janë aq efektive. Gratë me kancer gjirit me hormone jo të ndjeshme, mund të vlerësohen për një balancë të rreziqeve

dhe përfitimeve pas menopauzës. Nëse nuk është efektive, për gratë që kanë pësuar një histerektomi, rekomandohet terapia me estrogen nëpërmjet gojës, lëkurës ose vaginës. Përdorimi i terapisë hormonale sistemike nuk është domosdoshmërisht i kundër-ndikuar tek gratë me lloje të tjera të tumoreve të ndjeshme ndaj hormoneve, të tilla si tumori endometrium dhe tumorii vezoreve. Mjekët duhet të diskutojnë me gratë qasjet e ndryshme, përfshirë edhe ato të mjekësisë së integruar, duke identifikuar rreziqet dhe përfitimet.

6. Trajtimi i dhimbjes vaginale ose vulvare

Për problemet atrofike, si thatësia e vaginës apo vulvës, lubrifikuesit dhe hidratuesit të cilët duhen aplikuar vazhdimisht 3-5 herë në javë, mund të provohen si zgjidhja e parë. Për pacientët që nuk kanë efekt nga këto trajtime apo që kanë simptoma më serioze, ekzistojnë produkte me doza të ulëta estrogeni të cilat duhet të rishikohen

me vëmendje tek gratë që janë diagnostikuar me kancer gjiri, për të diskutuar me mjekun rreziqet dhe përfitimet. Por ekspertët e Asco nënvizojnë se për farmaci të ndryshme nuk ekzistojnë të dhëna të qarta që mund të lejojnë një vlerësim serioz, për të cilat pacientët duhet të vihen në dijeni. Kontraktimi i jo-vullnetshëm i muskujve të vaginës gjatë një akti seksual, stenoza vaginale, ose më saktë tkurra apo humbja e fleksibilitetit të vaginës, janë problematika të tjera të pranishme tek pacientët që ndjekin kurën kundër tumorit. Mund të jenë kushte shumë të dhimbshme, por mund të të lehtësohen përmes ushtrimeve fizioterapike për legenin ose muret e holla vaginale. Ekspertët e Ascos theksojnë se nëse është e nevojshme, mund të nisësh më pas një terapi kundër dhimbjes. Në raste të tilla dhimbjeje të vazhdueshme mund të konsiderohet edhe anestezia e pjeshme.

Përshtati në shqip: Fatjana Kazani



Foto ilustruese, marrë në Internet

Europa Donna Albania përzgjidhet nga 'Forumi European i Pacientëve'

Europa Donna Albania është përzgjedhur mes 70 aplikantëve për të qenë pjesë e modulit të trajnimit për 'Fuqizimin e Liderimit dhe Qeverisjes pozitive'. Ky modul ka si qëllim forcimin e organizatave të pacientëve në Europë, për të fuqizuar aftësitë e 'Leadership-it'.

Mes 70 aplikuesve janë përzgjedhur vetëm 24, ku ndër to është dhe Europa Donna Albania dhe do të përfaqësohet nga drejtuesja e kësaj organizate, Donjeta Zeqa. Ky modul është parashikuar në tre etapa. Etapa e parë është mbyllur në datën 23 prill, ku ishte dhe 'ballafaqimi' i parë mes të përzgjedhurve në një takim u zhvillua online.

Në këtë takim virtual u bë me dije nga ana e EPF se çfarë kanë për detyrë të përzgjedhurit të bëjnë si dhe u prezantuan pikat kryesore të këtij moduli. Ky takim online ishte i pari, i cili më pasoi me takimin "face to face" në Maj në Bratislava, Sllovaki. Një takim që shërbeu për t'u njohur me organizatat e tjera të pacientëve në Europë, që shërben për

vazhdimësinë e bashkëpunimeve të përbashkëta mes shteteve të ndryshme. Ky modul trajnimi për shoqatat e pacientëve në Europë, është një impenjim gjithëpërfshirës. Nga qershori deri në tetor do të bëhen trajnime individuale dhe në grup nëpërmjet mjeteve të komunikimit online. I gjithë cikli i trajnimeve do të përmbyllet me takimin e fundit në fillim të tetorit, në Varshavë, Poloni.

Çfarë është EPF?

EPF është organizata ombrellë e organizatave evropiane të pacientëve, aktive në fushën e mbrojtjes së shëndetit publik dhe advokimit për një shëndet më të mirë.

Forumi i Pacientëve European, i njohur gjerësisht si EPF, është një organizatë jofitimprurëse dhe e pavarur joqeveritare me bazë në Bruksel, Belgjikë. Ajo u krijua në vitin 2003 për t'u bërë zëri i fortë dhe i bashkuar i pacientëve për të vendosur pacientët në qendër të politikës dhe programeve të kujdesit shëndetësor të BE-së.



Impakti dhe sukcesi i advokimit, rimbursimi i barit të kancerit të gjirit

Hulumtimi aktual mbi advokimin fokusohet në përpjekjet e grupeve të pacientëve për të mobilizuar burimet dhe për të ndikuar në hulumtuesit dhe politikë-bërësit. Ky punim miraton një qasje të “mundësive për kuadrinim e mundësive politike” për të tërhequr vëmendjen ndaj strategjive të tjera të advokimit. Në një rast studimi të advokimit të pacientit të kancerit të gjirit të rimbursimit të Herceptinës, tregohet se si grupet e pacientëve u përpoqën të fitojnë qasje në politikë-bërje nëpërmjet tre strategjive të ndryshme të krijimit të mundësive. Artikulimi ka për qëllim krijimin e vetëdijes përmes ndërtimit të agjendës publike. Negociatat synojnë harmonizimin e kornizës ndërmjet palëve të interesuara të ndërvarura, duke organizuar takime.

Politizimi është një strategji për të ndikuar në axhendat e arenave politike. Europa Donna Albania arriti në krijimin e vetëdijes dhe mbështetjes, e cila pati një ndikim të konsiderueshëm tek aktorët e tjerë. Këto ndikime nga ana tjetër ndihmuan në politizimin e çështjes. Megjithatë, ndikimi përfundimtar në procedurat e rimbursimit u arrit vetëm pjesërisht për shkak të depolitizimit të strategjive të mbështetura në bazë të ideve të vazhdueshme që mbështetin një ndarje të veçantë të përgjegjësive në organizimin e kujdesit shëndetësor. Sipas këtyre ideve, kontrolli i kostos në kujdesin shëndetësor është një përgjegjësi mjekësore, jo politike.

Qeveria shqiptare ka miratuar listën e re me 36 barna të rimbursueshme. Medikamenti për kancerin e gjirit, “Herceptinë”, është përfshirë në këtë listë dhe pacientet do ta marrin edhe në spitale të tjera të vendit, për të lehtësuar procedurat. Në listë është përfshirë një formë-dozë e re e medikamentit Herceptine (subcutane), që mund të merret me shiringë, edhe në spitale të tjera të vendit.

Rimbursimi i këtij medikamenti, konsiderohet dhe sukses i organizatës Europa Donna Albania, e cila nëpërmjet shkresave zyrtare dhe takimeve të shumta me aktorët kryesorë të institucioneve përgjegjëse, arriti të ndikojë në vendimin e qeverisë për rimbursimin e këtij bari të domosdoshëm për pacientët me kancer gjiri të hershëm ose metastatik që kanë rezultuar HER2+.

Europa Donna Albania përfaqëson interesat e grave shqiptare lidhur me parandalimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit përballë institucioneve shëndetësore dhe autoriteteve publike të cilat e kanë për detyrë ta realizojnë këtë.

Kjo organizatë ngre zërin fort për të drejtat shëndetësore të pacientëve që përfaqëson dhe do të përdorim çdo instrument për të pasqyruar dhe përcjellë këtë shqetësim shumë të madh që lidhet direkt me jetën e grave me kancer gjiri, në institucionet përgjegjëse dhe në media. Europa Donna Albania nuk do e tolerojë mosrespektimin e të drejtave shëndetësore të pacientëve me kancer gjiri.



Të (mos) humbësh luftën me kancerin

Zëri dhe puna e Rita Bocaj do të vazhdojë të dëgjohet, për të ndryshuar realitetin e grave me kancer gjiri në Shqipëri.

Rita ishte një nga gratë dhe anëtarët më aktive të Europa Donna Albania. E gatshme për të ndihmuar dhe për të dhënë kontributin e saj për çdo iniciativë që kishte në qendër gruan me kancer gjiri, në këtë vend, Rita nuk ngurroi asnjëherë të 'bërtasë' më të madhe shqetësimet e tyre deri në media.

Për ironi të fatit dhe pse luftoi shumë ajo nuk ia doli dot. Lindur me datën 20 Janar 1965, Rita jetoi dhe shijoi çdo moment, duke luftuar deri në fund.


Rita Bocaj ndërroi jetë me 18.04.2018



Rita Bocaj, 1965-2018

'Caffe Donna', takim me anëtarët e EDA

Në datën 15 Prill, u zhvillua një takim me disa nga anëtarët e Europa Donna Albania. Një diskutim shumë frytdhënës ku u prezantuan ide të reja dhe u diskutua se çfarë mund të bëjmë më shumë për të përmirësuar ecurinë e organizatës dhe jetesën e grave me kancer gjiri në Shqipëri. Takime të tilla do fillojnë të bëhen traditë në EDA për të qenë sa më aktiv me gratë paciente dhe me anëtarët e rinj të organizatës të cilët kanë ide të reja dhe inovative. Ky aktivitet u zhvillua në një nga ambientet publike të Tiranës, tek "Reja". Takime të kësaj natyre kanë si qëllim përfshirjen aktive të anëtarëve në organizatë për të arritur qëllimin dhe objektivat e EDA-s. Çfarë është bërë deri tani dhe si mund të përmirësohemi? Shkëmbim idesh dhe eksperiencash për të përmirësuar performancën e 'Europa Donna Albania' dhe si mund të arrijmë ne të gjithë bashkë të përmirësojnë cilësinë e jetës së grave me kancer gjiri në Shqipëri.



Formular Anëtarësimi

Duke plotësuar formularin, ju regjistroni në regjistrat e anëtarësisë së organizatës Europa Donna Albania dhe do të mund të merrni informacione me anë të e-mail-it të cilat do të ju informojnë mbi aktivitetet që organizon Europa

Donna Albania, si dhe do të informoheni për më të rejat e zbulimeve mbi kancerin e gjirit dhe pajisjen me Kartën e Anëtarësisë, të cilën mund ta porosisni në çdo kohë pranë zyrave tona në Tiranë (adresën plotë e keni më poshtë).

Të dhënat personale do të grumbullohen, përpunohen, mbahen, mbrohen dhe ruhen në zbatim të ligjit nr 9887 dt 10.03. 2008 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në asnjë mënyrë nuk do ti jepen palëve të treta pa autorizimin me shkrim të subjekteve të të dhënave personale

Europa Donna Albania - Formular Antarësimi

Emri:

Mbiemri:

Profesioni:

Adresa:

Telefon/Celular:

E-mail:

Faks (nëse keni):

Data:

Firma:
.....



*Pasi të plotësoni formularin mund ta dërgoni nëpërmjet postës në adresën:
Rruga: Hoxhë Vokri, Godina e banimit Gora, apartamenti 31, kati 5, nr. 29.*



E-mail: europadonnaalbania@hotmail.com

E-mail: info@europadonna.al

Facebook: Europa Donna Albania

Instagram: [europadonnaalbania](https://www.instagram.com/europadonnaalbania)

Twitter: Europa Donna Albania (@donnaalbania)

Linkedin: Europa Donna Albania

Pasi të plotësoni formularin mund ta dërgoni nëpërmjet postës në adresën:
Rruga: Hoxhë Vokrri, Godina e banimit Gora, apartamenti 31, kati 5, nr. 29.

